




KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLËSIT SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABEVANJE D.D.
PRISHTINA



Duke u bazuar në nenin 34 të Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-111 dhe Ligjin nr.05/L-009, nenin 7 të Statutit të KRU “Prishtina” Sh.A., Bordi i Drejtorëve të KRU “Prishtina” Sh.A., miratoi këtë:

RREGULLORE

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR PUNËT E KRYERA NDAJ PALËVE TË TRETA

Dhjetor, 2022

Neni 1

Fushëveprimi dhe Qëllimi

Ky dokument i përcakton politikat si dhe procedurat e detajuara që duhet të ndiqen nga personeli i KRU 'Prishtina' Sh.A. (në tekstin e më tutjeshëm: 'Kompania') në rastet kur dëmtohet rrjeti i ujësjellësit apo kanalizimit nga personat fizik apo juridik.

Miratimi i këtij dokumenti ka këto qëllime:

1.1. Të vendoset një kornizë në bazë të cilës Kompania e organizon dhe koordinon punën e vet në lidhje me konstatimin dhe procedimin e rasteve të dëmtimit të infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit si rezultat i veprimeve të qëllimshme apo të pakujdesisë.

1.2. Të definohen veprimet specifike që duhet të ndërmerren nga departamentet përkatëse dhe personeli i Kompanisë me rastin e konstatimit dhe procedimit të personave të cilët shkaktajnë dëmtimin e rrjetit të ujësjellësit dhe/apo të kanalizimit si pasojë e punimeve të kryera nga ata në zonën e rrjetit të ujësjellësit apo kanalizimit me apo pa lejen e organit kompetent.

Neni 2

Zbatueshmëria

2.1. Rregullorja për përcaktimin e tarifave për punët e kryera ndaj palëve të treta është dokument zyrtar dhe i zbatueshëm i Kompanisë. Si i tillë është i zbatueshëm nga i gjithë personeli i Kompanisë që është i përfshirë në inspektimin, konstatimin dhe procedimin e rasteve të dëmtimit të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit. Po ashtu ky dokument është me interes edhe për konsumatorët si dhe palët tjera të interesit dhe prandaj është i publikuar në ueb-faqen e Kompanisë.

2.2. Mosrespektimi i këtyre politikave dhe procedurave paraqet shkelje të rëndë të rregullave të punës dhe rrjedhimisht sanksionohet me masa ndëshkimore konform procedurës disiplinore.

2.3. Për interpretimin e kësaj Rregullore dhe për zgjidhjen e keqkuptimeve eventuale apo rasteve të veçanta duhet të konsultohet Zyra Ligjore e Kompanisë.

Neni 3

Korniza Ligjore

3.1. Korniza ligjore për nxjerrjen e këtij dokumenti është bazuar në:

Rregullore nr.10/2019 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë;

Kodi nr.06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës;

Ligji nr.04/L-139 Ligji për Procedurën Përmbarimore.

Neni 4

Rastet e dëmtimit të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit

4.1. Procedurat e Kompanisë për Rastet e Dëmtimit të Rrjetit të Ujësjellësit dhe Kanalizimit demonstrojnë përkushtimin e saj për ruajtjen e pronës publike të cilën e menaxhon dhe operon ajo me qëllim të ofrimit të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit. Për këtë qëllim Kompania do të ndërmerr veprimet e nevojshme organizative, administrative dhe të tjera të cilat do të jenë në funksion të:

- Kontrollimit sistematik dhe konstatimit efektiv të të gjitha rasteve të dëmtimit të infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit;
- Bashkëpunimit efikas me të gjitha organet kompetente, para së gjithash me inspektoratet komunale, Policinë e Kosovës dhe Gjykatat kompetente;
- Ndërmarrjes së masave sanksionuese ndaj këtyre rasteve në pajtim me dispozitat ligjore;
- Kompensimit të dëmeve që i janë shkaktuar Kompanisë si rezultat i dëmtimit të rrjetit të ujësjellësit dhe/ose kanalizimit.

Neni 5

Konstatimi i Dëmit

5.1. Pas marrjes së informacionit për dëmin e shkaktuar në rrjetin e ujësjellësit apo të kanalizimit, përfaqësuesit e Kompanisë do të dalin urgjentisht në vendin e ngjarjes dhe do të hartojnë procesverbalin me shkrim për rastin. Njëkohësisht, ata do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të siguruar sa më shumë prova dhe informacione në lidhje me rastin, duke përfshirë:

- Fotografimin e vendit dhe objektit të dëmtuar;
- Fotografimin e mjetit me të cilin është shkaktuar dëmi;
- Marrjen e deklaratave nga shkaktuesit e dëmit apo dëshmitarët e rastit;
- Vlerësimin preliminar të dëmit të shkaktuar.

Neni 6

Bashkëpunimi me Organet Kompetente

6.1. Me qëllim të procedimit me sukses të rasteve kur dëmtohet rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit, Kompania do të bashkëpunojë ngushtë me të gjitha organet kompetente gjatë të gjitha fazave të procesit. Në këtë kontekst, personi përgjegjës i Kompanisë (Drejtori Teknik) do të bëjë të gjitha përpjekjet për të siguruar prezencën në vendin e ngjarjes të:

- Inspektoratit komunal për të regjistruar dëmtimet në procesverbalin e tyre;
- Policisë së Kosovës për të konstatuar rastin dhe për ta proceduar në pajtim me Kodin Penal të Kosovës.

Hapi i Parë: Konstatimi dhe Vlerësimi i Dëmtimit – Departamenti i Rrjetit

1. Pas marrjes së njoftimit për dëmtimin e rrjetit të ujësjellësit apo kanalizimit, qoftë nga qytetarët apo personeli i Kompanisë, zyrtari i Kompanisë që është përgjegjës për përgjigjen në telefonata (Dispeçeri-Call Center) do ta evidentojë njoftimin dhe do ta njoftojë urgjentisht Drejtorinë Teknike si dhe Menaxherin e Departamentit të Rrjetit të Ujësjellësit, respektivisht Menaxherin e Rrjetit të Kanalizimit (në tekstin e mëlutjeshëm: 'Menaxheri') varësisht se në cilin rrjet është shkaktuar dhe raportuar dëmtimi;
2. Drejtori Teknik do të urdhërojë menjëherë Menaxherin që të kontaktoj komisionin për konstatimin dhe vlerësimin preliminar të dëmtimit dhe të dalin në vendin e ngjarjes;
3. Menaxheri, në afat sa më të shkurtër prej momentit të marrjes së njoftimit, do të dal në vendin e ngjarjes bashkë me komisionin e Kompanisë për ta konstatuar dëmtimin;
4. Menaxheri, pas daljes në vendin e ngjarjes dhe konfirmimit se ka ndodhur dëmtimi, do të kontaktojë me Inspektoratin Komunal dhe me Policinë e Kosovës për t'i njoftuar me dëmtimin e shkaktuar dhe do të kërkojë nga këto institucione të dalin në vendin e ngjarjes për të evidentuar dëmin që i është shkaktuar Kompanisë;
5. Pas njoftimit të organeve kompetente, Menaxheri në bashkëpunim me anëtarët tjerë të komisionit të Kompanisë, do të bëjë observimet e duhura si dhe matjet dhe fotografimet e nevojshme që do t'i shërbejnë për hartimin e procesverbalit për dëmin (shih shtojcën nr.1);
6. Pas hartimit të procesverbalit dhe nënshkrimit të tij nga anëtarët e komisionit, i njëjti do ti ofrohet për nënshkrim edhe personit që ka shkaktuar dëmin;
7. Pasi të kenë kryer konstatimin në vendin e ngjarjes edhe përfaqësuesit e Inspektoratit Komunal si dhe ata të Policisë së Kosovës, Menaxheri e kompletion lëndën edhe me nga një kopje të procesverbaleve të Inspektoratit dhe Policisë dhe e përgatitë për procedim të mëlutjeshëm;
8. Pasi ta këtë kompletuar lëndën me informacionet e nevojshme nga vendi i ngjarjes, Menaxheri, në afat sa më të shkurtër dhe më së largu brenda 3 ditëve nga data e ndodhjes, do të kalkulojë dëmet e shkaktuara sipas çmimit të tregut. Ky kalkulim duhet të përfshijë: (a) të gjitha shpenzimet për riparimin e dëmit të shkaktuar, duke përfshirë
 - Koston e materialit të përdorur në riparim sipas çmimeve të furnizimit (të dhënat nga kontabiliteti)
 - Koston e orëve në të cilat kanë qenë të angazhuar punëtorët e KRU Prishtina Sh.A, sipas vlerë së orëve në kontratën e secilit nëpunës (të dhënat nga personeli)
 - si dhe vlerën e orëve të punës së makinerisë duke u bazuar në çmimet mesatare të kontraktorëve të ndërmarrjes për shërbime/makineri të njëjta ose përafërta (të dhënat nga prokurimi) dhe (b) sasinë e vlerësuar të ujit të humbur si pasojë e dëmtimit të rrjetit.

Hapi i Dytë: Faturimi i Dëmeve – Departamenti i Shitjes dhe Departamenti i Kontabilitetit dhe Thesarit

Lëndën e kompletuar bashkë me kalkulimin e dëmit të shkaktuar, Menaxheri do ta evidentojë dhe përmes Arkivit të Kompanisë, do t'ia dërgojë Departamentit të Shitjes për të përgatitur faturën me kostot e kompensimit të dëmit të shkaktuar;

Menaxheri i Departamentit të Shitjes në ditën e njëjtë e përpilon faturën dhe një kopje të kompletuar të lëndës bashkë me faturën e dërgon përmes arkivit të Kompanisë tek Departamenti i Kontabilitetit dhe Thesarit dhe tek Zyra Ligjore e Kompanisë për procedim të mëtutjeshëm.

Në Departamentin e Kontabilitetit dhe Thesarit fillimisht regjistrohet si faturë e shitjes dhe kontohet si të hyrat nga dëmet.

Pagesa regjistrohet pas pranimi të raportit bankar

Hapi i Tretë: Procedimi i Rastit – Zyra Ligjore e Kompanisë

Zyrtari Ligjor i Kompanisë, pasi ta pranojë lëndën nga Departamenti i Shitjes, brënda 24 orëve, do ti bëjë kërkesë për kompensim të dëmit personit i cili e ka shkaktuar dëmin duke i dhënë atij një afat prej 8 ditëve për pagesën e faturës për dëmin e shkaktuar;

Pas skadimit të afatit prej 8 ditëve prej datës së dërgimit të kërkesës për kompensimin e dëmit, nëse nuk kryhet pagesa e faturës nga ana e personit që ka shkaktuar dëmin, Zyra Ligjore e Kompanisë do të iniciojë procedurën përmbarimore.

Neni 7

Në rastet kur një institucion shtetëror dorëzon kërkesë me shkrim për riparim të rrjetit të ujit apo kanalizimit të cilën paraprakisht e pranon që t'i barte shpenzimet e punëve të kryera përmes një deklarate me shkrim të protokolluar, me pëlqimin e Drejtorisë Teknike dhe të KE-së, Departamenti përkatës lëndën e kompletuar me kalkulimin e kostos kushtuese për punët e kryera (sipas kalkulimeve tek Hapi i Parë) dhe e dërgon te Departamenti i Shitjes për përgatitje të faturës.

Neni 8

Dispozitat Përfundimtare

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dokument paraprak që rregullojnë këtë fushë.

Kjo rregullore hynë në fuqi nga dita e miratimit nga Bordi i Drejtorëve të KRU "Prishtina" Sh.A.

Kryesuesja e Bordit të Drejtorëve
znj. Teuta Ukshini-Aliu

The image shows a circular official stamp of KRU "Prishtina" Sh.A. The stamp contains the text "KRU 'PRISHTINA' SH.A.", "PRISHTINE", and "KRYESUESJA E BORDIT TË DREJTORËVE". Overlaid on the stamp is a handwritten signature in blue ink.

SHTOJCAT



KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABDEVANJE D.D.

PRISHTINA

Shtojca 1: Formati i Procesverbalit mbi Regjistrimin e Dëmtimit

Njësia Operative _____

Datë: _____

N/R: _____

PROCESVERBAL

- Mbi Regjistrimin e Dëmtimeve në Rrjetin e Ujësjetës dhe Kanalizimit –

Shkaktuesi i dëmit: _____

Adresa: _____

Numri personal/emri kompanisë dhe përfaqësuesit të saj:

Vendi ku ka ndodh dëmtimi i _____

rrjetit: Përshkrimi i dëmit:

Vlerësimi i dëmit të shkaktuar do të bëhet në afat prej 3 ditësh nga shërbimi profesional i KRU "Prishtina" Sh.A., i cili dëm do t'i faturohet shkaktuesit të saj.

Shkaktuesi i dëmit është i obliguar që të paguajë dëmin e shkaktuar në tërësi në afat prej 8 ditësh, nga momenti i shkaktimit të dëmit, në të kundërtën kundër tij do të inicohet padi për kompensim dëmi në gjykatën kompetente.

Vërejtje:

Komisioni i KRU "Prishtina" Sh.A.

1. _____
2. _____
3. _____

Shkaktuesi i dëmit:

Bashkangjitur: *Fotografite e bëra në vendin e ngjarjes*
Deklarata të dëshmitarëve
eventual Procesverbali i
Inspektoratit Komunal

☐
☐
☐